

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org.	rr-02	Nr i Prot.	
Org.Jedinita		Broj Prot.	2966-2/24
Nr i Faqeve	-09-	Prot. No.	
Bc Stranica		Data:	
No.Pages		Date:	30.01.24
PRISHTINË / A			No.1



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
 Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.01.2025
REFERENC-Ë:	24/2966/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Graniti & Co", Sh.p.k., Suharekë Thermim , seperim i gurit gëlqero Bardhë, K. Malishevë.
	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "Graniti & Co", Sh.p.k., Suharekë, me Nr. Prot. 24/2966/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. 24/2966/MMPHI
Datë: 17.01.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori, "Graniti & Co", Sh.p.k., Suharekë me Nr. Prot. 24/2966/MMPHI, **pajiset me Leje Mjedisore** për veprimtarinë: Thërmim, seperim i gurit gëlqeror në ngastrën nr. 21 dhe nr. 34-0, fleta poseduese Nr.99, zona kadastrale Bardhë, Malishevë.
2. Operatori obligohet:
 - 1.1. Të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 1.2. Sistemi de- pluhurues të jetë funksional;
 - 1.3. Raporti për lirimin e pluhurit në ajër të dorëzohet në MMPHI;
 - 1.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit të mjedisit që është përgjegjës për mjedis;

Faqe 2 nga 4



- 1.5. Vazhdimisht të behët spërkatja me ujë e sipërfaqes operacionale dhe shiritave qe përdoren për transportin dhe seperimin e gurit gëlqeror;
- 1.6. Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi i terrenit sipas përshkrimit në aplikacion;
- 1.7. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;
- 1.8. Të mirëmbahet sipërfaqja operacionale, për largimin e vajrave dhe derivateve të naftës.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin është konstatuar se " Graniti & Co",Sh.p.k.,me nr.prot. 24/2966/MMPHI, Suharekë, për veprimtarinë: Thermim , seperim i gurit gëlqero Bardhë, K. Malishevë, në ngastrën nr. 21 dhe nr. 34-0, fleta poseduese Nr.99, zona kadastrale Bardhë, Malishevë, MMPHI konstaton që operatori i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit-ARBK;
- Pëlqimit Mjedisor me Nr. 12/2134/2-ZSP/243/12, te lëshuar me dt. 10.11.2012;
- Vendim për korrigjim të Pëlqimit Mjedisor me Nr. 1/162/1-ZSP/119/13, te lëshuar me dt. 14.02.2013;
- Vendim për transfer të Pëlqimit Mjedisor me Nr. 16/5905/1-ZSP/ 50/17, te lëshuar me dt. 14.02.2017;
- Licencë për seperacion, Nr.3652, nr. 889/KPMM/2022, me afat gjerë me: 10.09.2027;
- Kontratë nga APK, për qeran e tokës pyjore me nr. ref: KE-338/22 të dt.07.06.2022.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet administrative dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.



Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Malishevë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së